

## Konkurs Për vende të lira pune

<b>Organizata</b>	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara)
<b>Qëllimi i Angazhimit</b>	Ofrimi i shërbimeve të kujdesit ditor
<b>Lokacioni</b>	Ferizaj, Kosovë
<b>Kohëzgjatja</b>	13 muaj

### **HANDIKOS**

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara- Handikos-Ferizaj, punon për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri si dhe aktivisht lobon dhe mbron në nivel lokal të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Handikos-Ferizaj në kuadër të projektit “Shërbime të kujdesit ditor me bazë në komunitet për personat me aftësi të kufizuara (PAK)”, i cili realizohet në partneritet me Save the Children, me financim nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës të personave me aftësi të kufizuara të komunës së Ferizajt, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të kujdesit ditor.

### **Qëllimi i përgjithshëm**

Si përpjekje për të përmbushur zbrazëtirat në ofrimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara (PAK) që jetojnë në komunën e Ferizajt, Handikos synon të përmirësojë, mbulojë dhe të sigurojë cilësi dhe qëndrueshmëri të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të kujdesit ditor.

Duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, mbështetjen e pjesëmarrjes së tyre në procese sociale dhe mbështetjen e familjeve të tyre, ne po kërkojmë të angazhojmë:

### **Një (1) Asistent/e i/e Mirëqenies Sociale-** Paga: 342.86 Euro (Bruto)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të lehtësoj funksionimin personal dhe interpersonal të individit, duke u fokusuar në çështjet emocionale, sociale, shëndetësore dhe të tjera;
- Të ndihmojë në përmirësimin e mirëqenjes, lehtësimin e shqetësimeve, përballimin e çështjeve që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuara dhe ofrimin e mënyrave dhe mjeteve për një jetë më funksionale;
- Të forcojë vetëdijen dhe vetëpranimin e individit;
- Të krijojë dhe forcoj vetëbesimin e individit;

- Të ndihmojë individët që të lehtësohen prej simptomave të lidhura me çrregullime të stresit dhe ankthit.

## Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare – Fakulteti i Shkencave Sociale
- Licencë për shërbime sociale dhe familjare ( e preferueshme )
- Të paktën një (1) vit përvojë pune profesionale ( e preferueshme )
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Patentë shoferin- kategoria B (e preferueshme)

## **Një (1) Punëtor/e Psiko-social/Psikolog/e** Paga: 342.86 Euro (Bruto)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ofrojë terapi psiko-sociale / profesionale të individit / grupit
- Punon për të lehtësuar funksionet personale dhe interpersonale të individit duke u fokusuar në çështje emocionale, sociale, shëndetësore etj.
- Të iu ndihmoj njerëzve për të përmirësuar mirëqenien e tyre, lehtësuar fatkeqësinë, zgjidh probleme dhe të iu siguroj shkathtësi për të jetuar jetë më funksionale.

## Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare, dega Psikologji;
- Licencë për shërbime sociale dhe familjare ( e preferueshme )
- Të paktën një (1) vit përvojë pune profesionale ( e preferueshme )
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Patentë shoferin- kategoria B (e preferueshme)

## **Një (1) Punëtor/e për aktivitete** -Paga: 304.76 Euro (Bruto)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ndihmojë individët që të performojnë aktivitete rekreative gjatë qëndrimit ditor në qendër me qëllim të bashkëveprimit ndërgrupor të tyre.
- Të organizoj dhe fasilitoj takime ditore për të gjithë anëtarët të cilat mund të bëhen në formë të shëtitjeve, vizatimeve, punë-dore, lojëra të ndryshme mësimore në mënyrë të zhvillimit të mëtutjeshëm të intelektit të tyre.

## Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare në shkenca sociale
- Licencë për shërbime sociale dhe familjare (e preferueshme)
- Të paktën një (1) vit përvojë pune profesionale ( e preferueshme )

- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;

## **Një (1) Vozitës - Paga: 285.71 Euro (Bruto)**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të bëjë transportin e personave me aftësi të kufizuar dhe të stafit, në baza ditore;
- Të bëjë transportin në raste të shëtitjeve dhe evenimenteve të tjera;
- Të punojë ngusht me asistentin/en administrativ/e dhe pjesën tjetër të ekipit me qëllim të organizmit dhe planifikimit dhe për të pranuar informata për destinacionet, pikë takimet etj.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Patent shoferi – kategoria B (e obliguar)
- Të paktën dy (2) vite përvojë pune profesionale (e preferueshme)

## **Aplikuesit duhet të dorëzojnë**

- Kopjen e diplomës së shkollimit;
- Dëshmitë e kualifikimit dhe përvojës së punës;
- Nje letër motivimi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm për pozitën e punës;
- Dy rekomandime nga punëdhënës paraprakë
- Curriculum Vitae (CV);
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e patentë shoferit (aty ky është e obliguar)

## **Procedurat e aplikimit**

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në: [handikos\\_ferizaj@hotmail.com](mailto:handikos_ferizaj@hotmail.com) dhe/ose [handikosferizaj@gmail.com](mailto:handikosferizaj@gmail.com) me subjektin *Aplikoj për “emri i pozitës që aplikoni”*, apo në zyrat e Handikos-Ferizaj, Rr: Ramadan Rexhepi, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 03 Korrik 2018, ora 16:00.